

REZOLUTË

- Me vendosmërinë për të respektuar e garantuar rendin kushtetues, sigurinë publike, jetën dhe pronën e qytetarëve shqiptarë, si dhe të drejtat e liritë e njeriut;

- Me vullnetin për të vazhduar politikat që i shërbejnë zhvillimit të gjithanshëm të vendit e të shoqërisë e, në mënyrë të veçantë, të zhvillimit ekonomik e social të çdo individi;

- Të angazhuar për të ndjekur kursin e reformave të nevojshme për të çuar përpara integrimin europian të vendit;

- Të vendosur për të ruajtur stabilitetin politik demokratik të vendit, me synimin që Shqipëria të luajë një rol të respektuar e në rritje në organizatat ndërkombëtare, përfshirë edhe NATO-n;

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë:

- Vëren se në një rrethim të pashembullt banditesk të godinës së Këshillit të Ministrave, falangat e dhunës, të nxitura dhe të drejtura nga kreu i Partisë Socialiste në të ashtuquajturën demonstratë, tentuan të pushtonin Kryeministrinë dhe të përmbysnin me dhunë Qeverinë legjitime dhe rendin kushtetues.

- Vëren se ky skenar grusht shteti, i projektuar deri në detaje nga kryeorganizatori, kryetari i Partisë Socialiste, ishte paralajmëruar me kërcënim në seancën plenare të datës 17 janar 2011 dhe në vijim përsëritur një ditë më vonë nga ai vetë teksa deklaronte publikisht mosmbajtjen e përgjegjësive për dhunën që do të ndodhte më 21 janar 2011.

- Konstaton se grushti i dështuar i shtetit, që u përcoll me tmerr dhe me përçmim nga të gjithë shqiptarët dhe faktori ndërkombëtar, ka dëmtuar rëndë imazhin e Shqipërisë dhe prestigjin e merituar të reformave historike që ky vend ka ndërmarrë.

- Konstaton dhe vlerëson me kënaqësi se banda e puçistëve u la në vetminë e krimit të vet nga populli protestues dhe nga qytetarët e Tiranës.

Kuvendi i Shqipërisë:

- Dënon fuqishëm e pa ekuivok aktet e dhunës dhe tentativën e dështuar për grusht shteti, ndaj Qeverisë së ligjshme dhe rendit kushtetues demokratik.

- Shpreh përbuzjen më të thellë për nxitësit, organizatorët dhe ekzekutorët e grushtit të shtetit.

- Bën përgjegjës, për sa ndodhi, kryetarin e PS dhe politikanët e tjerë rreth tij. U bën thirrje atyre të ndërpresin menjëherë çdo veprim të mëtejshëm në funksion të cenimit të rendit kushtetues, si dhe u kërkon organeve të zbatimit të ligjit të marrin të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar e penguar përshkallëzimin e këtyre akteve kriminale.

- Kërkon hetim të shpejtë, të besueshëm, të pavarur dhe profesional të veprave penale, si dhe vënien para drejtësisë të autorëve të tyre.

- Shpreh mirënjohjen e thellë dhe mbështetjen e fuqishme për Policinë e Shtetit dhe Gardën e Republikës, të cilat, me vetëmohim dhe sakrificë, përballuan me sukses detyrën e tyre për mbrojtjen e rendit kushtetues në vend.

- Shpreh keqardhjen për ata që humbën jetën gjatë akteve të dhunshme dhe i uron personelit të policëve të lënduar shërim të shpejtë.

- Falënderon SHBA-në, BE-në, OSBE-në e Këshillin e Europës për qëndrimin e qartë në dënimin e akteve të dhunës në datën 21 janar 2011.

- Siguron dhe garanton qytetarët shqiptarë se ruajtja e rendit kushtetues, siguria publike, jeta dhe prona e tyre janë të garantuara nga shteti ligjor.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

23 janar 2011